



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.18/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj-kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Koalicija Vakati, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3770/2025, të datës 10.12.2025, për Refuzimin e Rekomandimit të Zyrës së Certifikimit të Kandidatës së Koalicionit Vakati, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZP.Anr.18/2025, e datës 11.12.2025, e paraqitur nga subjekti politik Koalicija Vakati, me të cilën është kërkuar që të anulohet Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Nr. Protokolli 01/3770/2025, të datës 10.12.2025, dhe detyrohet KQZ-ja, që të aprovojë rekomandimin e Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike dhe ta certifikoj kandidaten znj.Ena Krasniqi në listën e subjektit politik "Koalicija Vakati", me numër rendor 6, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 11.12.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Koalicija Vakati, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me të cilën pretendojnë se ky subjekt ka pranuar vendimin e KQZ-së me të cilin është refuzuar certifikimin e kandidates Ena Krasniqi për listën e kandidatëve të këtij subjekti politik. Në ankesë theksohet se në mbledhjen e mbajtur të KQZ-së kanë refuzuar pa asnjë bazë faktike rekomandimin e organit të vetë profesional Zyrës Për Certifikimin e Partive Politike, ku pas rekomandimit anëtarët e deleguara të partive politike me shumicë vote duke vepruar në kundërshtim me rekomandimin e Zyrës, duke ia mohuar të drejtën kushtetuese dhe ligjore kandidates Ena Krasniqi.

Më tej në ankesë theksohet se kandidatja në fjalë i ka përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pjesëmarrje në zgjedhje dhe se përveç origjinës së gjakut nga njëri prind, kandidatja Ena Krasniqi, për nga gjaku i takon përkatësisë etnike boshnjake është rritur në kulturën boshnjake e ka gjuhën amëtare gjuhën boshnjake, se është e lindur nga nëna e saj Mirsada

Kamberovic dhe se duke qenë gjatë tërë kohës me familjarët e saj boshnjake në Kosovë të njëjtës askush nuk mund të ia mohojë përkatësinë etnike të saj.

Sipas parashtruesit të ankesës vendimi i marrë nga KQZ përveç që i ka cenuar të drejtat individuale themelore të njeriut ndaj kandidatës Ena Krasniqi, ka cenuar dhe rrezikon në tërësi rendin juridik kushtetues, për sa i takon trajtimin të barabartë të pakicave kombëtare. Kandidatja Ena Krasniqi, ka shtetësinë e Kosovës, ka numrin personal, origjinë familjare, dhe deklarimin e saj të lirë, se cilit komunitet i takon dhe në rastin konkret edhe kur ka kontaktuar gjatë këtij kandidimi me zyrtarët profesional të KQZ-së është deklaruar përmes emailit se ndjehet dhe i takon komunitetit boshnjak të Kosovës, është anëtare e subjektit politik Koalicija Vakat dhe se përmes dokumenteve personale letërnjoftimit, ekstraktit të lindjes, numrit personal të saj dhe të pasaportës dhe vendbanimit të përhershëm në Kosovë ka përmbushur kushtet ligjore si çdo shtetas i Republikës së Kosovës. Kanë kërkuar nga PZAP, që ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar dhe ta anulojë vendimin e KQZ-së nr.01-3770-2025 të datës 10.12.2025 dhe ta detyroj KQZ ta aprovoj rekomandimin e Zyrës për certifikimin e kandidatës Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicija Vakat me numër rendor 6.

Në përgjigje KQZ, sqaron se në mbledhje e KQZ e mbajtur me datën 10.12.2025, Zyra i ka rekomanduar KQZ, certifikimin e listave të kandidatëve të subjekteve politike të certifikuara për pjesëmarrje në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Rekomandimi për certifikimin e kandidatëve ka përmbajtur listat e kandidatëve për njëzet e tri (23) subjekte politike të certifikuara, përfshirë të gjithë kandidatët (43 kandidatët) e subjektit politik KOALICIJA VAKAT. KQZ ka aprovuar rekomandimin e Zyrës për certifikimin e dyzet e dy (42) kandidatëve nga lista totale me dyzet e tre (43) kandidatë gjithsejtë të subjektit politik KOALICIJA VAKAT, duke refuzuar rekomandimin e Zyrës për certifikimin e kandidatit me numër rendor 6, ENA KRASNIQI, për shkak të pamundësisë së verifikimit të përkatësisë etnike të kandidatës, me arsyetimin se çështja t'i lihet për shqyrtim dhe vendimmarrje, PZAP dhe instancave gjyqësore.

Më tej në përgjigje KQZ thekson se me datën 08.12.2025, përmes postës elektronike (e-mail) Zyra ka pranuar njoftimin nga anëtari i KQZ në lidhje me përfshirjen e kandidatës Ena Krasniqi, me numrin e renditur 6 në kuadër të subjektit politik KOALICIJA VAKAT, me pretendimet se kandidatja i përket etnisë shqiptare dhe është familjare e ish deputetes së Kuvendin të Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS. Në lidhje me pretendimet, janë bashkangjitur dëshmitë që ndërlidhen me profilin e kandidatës në rrjetet sociale (facebook).

Regjistri qendror i gjendjes civile i Republikës së Kosovës është dokumenti unik shtetëror, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas të Kosovës. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri personal, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja martesore, vdekja, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera; Shtetësia e Kosovës, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi. Baza e të dhënave që pranohet nga Agjencia e Regjistrimi Civil, nga e cila krijohet edhe lista e votuesve nuk përmban informatën për përkatësinë etnike dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë informacion, ku shtetasit e Republikës së Kosovës

identifikohen në bazë të përkatësisë etnike. Nga analiza e dokumenteve që subjekti politik KOALICIJA VAKAT i ka dorëzuar në Zyrë sipas kërkesë: Në dokumentin identifikues (letërnjoftimi) ENA KRASNIQI ka lindur në Sarajevë dhe ka vendbanimin në Banjë të Istogut, me shtetësi Kosovare; Sipas ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile, i lëshuar me datën 08.12.2025, sipas të dhënave për prindërit, dëshmohej se njëri prind është i lindur në Sarajevë dhe ka kombësi boshnjake.

Më tutje thuhet se në e-mailin që Zyra e ka pranuar me datën 08.12.2025 nga kandidatja Ena Krasniqi, e njëjta ka deklaruar se është e lindur në Sarajevë dhe deklarohet se i përket etnisë boshnjake.

Zyra me datën 09.12.2025 ka kërkuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës informata në lidhje me deklarin e përkatësisë etnike për kandidaten Ena Krasniqi, nga procesi i regjistrimit të popullsisë në vitin 2024. Në përgjigjen e ASK në po të njëjtën datë, jemi njoftuar se duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare, ASK nuk është e autorizuar të ndajë, të konfirmojë apo të publikojë çfarëdo të dhëne individuale, qoftë edhe vetëm një element, në lidhje me një person të caktuar. Të dhënat statistikore përdoren vetëm me qëllime statistikore dhe nuk mund t'u jepen palëve të treta për qëllime administrative, verifikimi apo procese të tjera.

Sipas verifikimit vetëm me emër dhe mbiemër, kandidatja Ena Krasniqi, ka qenë candidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS në Zgjedhjet Lokale të vitit 2009. Në Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale nuk garohet për vendet e garantuara.

PZAP sipas vendimit A.nr, 14/ 2021, datë 25.01.2021, pat detyruar KQZ që ta de certifikoj kandidatin Emin Neziraj, i cili në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës ka qenë në listën e kandidatëve nga radhët e subjektit politik NOVA DEMOKRATSKA STRANKA. Arsye e de certifikimit ka qenë se kandidati (E.N) me datën 07.10.2025 ka deklaruar se ka qenë kandidatë nga radhët e subjektit politik NISMA SOCIALDEMOKRATE për Zgjedhjet Lokale 2017 dhe ka deklaruar se është shqiptar. Në pamundësi të verifikimeve zyrtare që lidhet me përkatësinë etnike të kandidatës ENA KRASNIQI nga radhët e subjektit politik KOALICIJA VAKAT, Zyra i ka rekomanduar KQZ që ta certifikoj të gjithë listën e kandidatëve, përfshirë kandidaten ENA KRASNIQI.

Në takimin nr. 95 të KQZ të mbajtur më 10.12.2025, Zyra ka prezantuar rekomandimin për certifikimin e listës së kandidatëve të KOALICIJA VAKAT duke përfshirë edhe kandidaten ENA KRASNIQI. Pas diskutimeve nga anëtarët, u vendos të hidhet në votim lista e kandidatëve të subjektit në fjalë pa kandidaten ENA KRASNIQI. Ky propozim u votua me dhjetë(10) vota për, rrjedhimisht u refuzua certifikimi i kandidatës me numër 6 në listën e kandidatëve të subjektit politik KOALICIJA VAKAT.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka shqyrtuar pretendimet e palëve në procedurë si dhe Vendimin e KQZ-së Nr. 01/3770/2025, të datës 10.12.2025, dhe pasi ka bërë vlerësimin e pohimeve të palëve, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), **ka refuzuar si të pabazuar ankesën** dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, për arsyet e paraqitura në vijim:

Nga vendimi i KQZ-së, Nr. 01/3770/2025, të datës 10.12.2025 paneli konstaton se është refuzuar certifikimi i kandidates Ena Krasniqi për listën e kandidatëve të subjektit politik Koalicioni Vakati, që garojnë për vendet e garantuara për minoritetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

Paneli i PZAP-it, vlerëson ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së, Nr. 01/3770/2025, të datës 10.12.2025 dhe konstaton se i njëjti është në harmoni të plotë me nenin 111 par.1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë: 2. Njëqind e njëzet (120) vendet në Kuvend zgjidhen me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura dhe ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon: 2.1. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); 2.2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t’i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.*

PZAP vlerëson se kur një subjekt politik që garon në zgjedhje, për vendet e garantuar, për përfaqësim të komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, fillimisht specifikohet se cilit komunitet i takon subjekti politik që garon në zgjedhje dhe nëse subjekti politik dëshiron të garoj për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës, është i njoftuar paraprakisht, me dispozitën e lart cituar ligjore. Në këtë rast subjektit politik KOALICIJA VAKAT është certifikuar si parti për të marrë pjesë në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, sipas aplikacionit të ofruar nga KQZ, ku edhe ka aplikuar që në këto zgjedhje të garoj për të marr vende të garantuara për përfaqësim të komuniteteve tjera jo shumicë, sipas nenit 16, par.12 të LZP dhe nenit 64 të Kushtetutës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 64, i rregullon vendet e rezervuara për komunitetet jo-shumicë, të cilat kanë për qëllim garantimin e pjesëmarrjes reale dhe efektive të këtyre komuniteteve në jetën institucionale të vendit. Sipas PZAP ky nen nuk krijon të drejtë për subjektet politike që, për qëllime të fitimit të vendeve të rezervuara, të përfshijnë në listat e komunitetit persona që nuk kanë lidhje identitare me komunitetin përkatës, por kërkon që këto vende t’u takojnë përfaqësuesve autentikë të komunitetit që synohet të përfaqësohet. PZAP vlerëson se përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në Kuvend, përmes vendeve të rezervuara, nuk mund të jetë as formal e as fiktiv, por duhet të mbështetet në ekzistimin e një

lidhjeje objektive ndërmjet përfaqësuesit dhe komunitetit përkatës. Kjo lidhje objektive mund të shprehet përmes elementeve si përkatësia etnike, përdorimi i gjuhës, identiteti kulturor, apo angazhimi publik dhe shoqëror brenda komunitetit.

Në rastin konkret, subjekti politik VAKAT gëzon statusin e partisë politike të komunitetit boshnjak dhe garon për vendet e rezervuara të parashikuara për këtë komunitet. Për rrjedhojë, kandidatët e këtij subjekti duhet të kenë lidhje reale, të vërtetë dhe të provueshme me komunitetin boshnjak. Kandidatja Ena Krasniqi në ankesën e saj ka pretenduar se për nga gjaku i takon përkatësisë etnike boshnjake, e cila është rritur në kulturën boshnjake, gjuhën amëtare gjuhën boshnjake, se është e lindur nga nëna e saj Mirsada Kamberovic dhe se duke qenë gjatë tërë kohës me familjarët e saj boshnjake në Kosovë të njëjtës askush nuk mund të ia mohojë përkatësinë etnike të saj. PZAP vlerëson se nga shkresat e lëndës rezulton se, me rastin e aplikimit për certifikim, si dhe më pas përmes ankesës para PZAP-it, kandidatja Ena Krasniqi nuk ka paraqitur asnjë provë që do të dëshmonte ekzistimin e lidhjes objektive me komunitetin boshnjak, në veçanti lidhjen e përkatësisë etnike, pa përjashtuar elemente të tjera si gjuha apo identiteti kulturor. Po ashtu, kandidatja nuk ka ofruar argumente që do të kundërshtonin pretendimin se në zgjedhjet lokale të vitit 2009 ka marrë pjesë si kandidate në listën e një subjekti politik të komunitetit shumicë.

Mbi këtë bazë, Paneli vlerëson se KQZ, me Vendimin Nr. 01/3770/2025, të datës 10.12.2025, ka vepruar drejtë kur ka refuzuar rekomandimin e Zyrës për Certifikim lidhur me certifikimin e kandidates Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicioni Vakut. Kjo për arsye se Koalicioni Vakut garon për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025 për vendet e garantuara, të cilat, në përputhje me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 111 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, janë vende ekskluzivisht të rezervuara dhe të garantuara për komunitetet joshumicë në Republikën e Kosovës, e jo për komunitetin shqiptar. Për këtë arsye, dhe bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendet e garantuara, janë të obliguara që në listat e tyre të kandidatëve për deputetë të përfshijnë vetëm kandidatë nga komuniteti të cilit i përket subjekti politik përkatës, e jo nga komuniteti shqiptar. Në rastin konkret, Koalicioni Vakut nuk ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore dhe me procedurat për aplikim të subjekteve politike që garojnë për vendet e garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP vlerëson se vendimi i KQZ-së për mos certifikimin e kandidates nuk përbën cenim të nenit 45 të Kushtetutës. E drejta për t'u zgjedhur, ndonëse e garantuar, nuk është e drejtë absolute dhe ushtrohet brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj. Në rastin konkret, kandidatja nuk po pengohet të marrë pjesë në zgjedhje në përgjithësi, por po kufizohet nga kandidimi në listën e një subjekti politik që përfaqëson një komunitet tjetër, për të cilin ajo nuk ka dëshmuar ekzistimin e lidhjes objektive të kërkuar.

Në këto rrethana, PZAP vlerëson se certifikimi i kandidates në listën e subjektit politik të komunitetit boshnjak do të rrezikonte shtrembërimin e funksionit kushtetues të vendeve të rezervuara, ndërsa mos certifikimi paraqet një masë të nevojshme dhe proporcionale për mbrojtjen e identitetit, përfaqësimit dhe integritetit politik të komunitetit boshnjak


Andaj, nga arsyet e lart theksuara konform nenit 118 par. 1 dhe nenit 119 par 3 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.18/2025 më datën 13.12.2025.

Kryesuesi i Panelit
Skender Ceqaj



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 48 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.132/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Qerim Ademaj kryetar i kolegjit, Milena Djerić dhe Faton Ademi, anëtarë, lidhur me ankesën subjektit politik, Koalicija Vakati, me bazë refuzimin e rekomandimit të Zyrës së Certifikimit të Kandidates së Koalicionit Vakati, për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.18/2025, të datës 13.12.2025, në seancën e mbajtur më datë 16.12.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e subjektit politik, Koalicija Vakati, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.18/2025, i datës 13.12.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.18/2025, të datës 13.12.2025, ka vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa ZP.Anr.18/2025, e datës 11.12.2025, e paraqitur nga subjekti politik Koalicija Vakati, me të cilën është kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Nr. Protokolli 01/3770/2025, të datës 10.12.2025, dhe detyrohet KQZ-ja, që të aprovojë rekomandimin e zyrës së vet për certifikimin e kandidatës znj. Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicija Vakati, me numër rendor 6, për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Koalicija Vakati, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi të gabuar të gjendjes faktike, duke propozuar që të aprovet në tërësi si e bazuar ankesa e subjektit politik Koalicija Vakati, të anulohet vendimi i PZAP-së, ZP.Anr.18/2025, i datës 13.12.2025 dhe vendimi



i KQZ-së Nr. 01/3770-2025, i datës 10.12.2025, ashtu që të detyrohet KQZ-ja që të aprovojë rekomandimin e zyrës së vet për certifikimin e kandidates Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicija Vakrat, me numër rendor 6.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Koalicija Vakrat, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.18/2025, i datës 13.12.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:


- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 11.12.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Koalicija Vakrat, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me të cilën pretendojnë se ky subjekt ka pranuar vendimin e KQZ-së me të cilin është refuzuar certifikimi i kandidates Ena Krasniqi për listën e kandidatëve të këtij subjekti politik, duke theksuar më saktësisht si në ankesën e paraqitur në PZAP.

KQZ më datë 11.12.2025, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka dhënë sqarime lidhur me procedurën e ndjekur, arsyet dhe rrjedhën se si ka ardhur deri te vendimi i KQZ-së, duke theksuar më saktësisht si në përgjigje në ankesë.

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë nga ana e KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.18/2025, të datës 13.12.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e subjektit politik, Koalicija Vakrat, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli i PZAP-it, vlerëson ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së, Nr. 01/3770/2025, të datës 10.12.2025 dhe konstaton se i njëjti është në harmoni të plotë me nenin 111 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: "Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë: 2. Njëqind e njëzet (120) vendet në Kuvend zgjidhen me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura dhe ndahen midis të gjitha partive, koalicionëve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon: 2.1. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); 2.2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran me (1) vend".



nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara”.

Ka shtuar se PZAP vlerëson se kur një subjekt politik që garon në zgjedhje për vendet e garantuara, për përfaqësim të komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, fillimisht specifikohet se cilit komunitet i takon subjekti politik që garon në zgjedhje dhe nëse subjekti politik dëshiron të garoj për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës, është i njoftuar paraprakisht, me dispozitën e lartcitur ligjore. Në këtë rast subjektit politik Koalicija Vakrat është certifikuar si parti për të marrë pjesë në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, sipas aplikacionit të ofruar nga KQZ, ku edhe ka aplikuar që në këto zgjedhje të garoj për të marrë vende të garantuara për përfaqësim të komuniteteve tjera jo shumicë, sipas nenit 16, par. 12 të LZP dhe nenit 64 të Kushtetutës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 64, i rregullon vendet e rezervuara për komunitetet jo-shumicë, të cilat kanë për qëllim garantimin e pjesëmarrjes reale dhe efektive të këtyre komuniteteve në jetën institucionale të vendit. Sipas PZAP ky nen nuk krijon të drejtë për subjektet politike që për qëllime të fitimit të vendeve të rezervuara, të përfshijnë në listat e komunitetit persona që nuk kanë lidhje identitare me komunitetin përkatës, por kërkon që këto vende t'u takojnë përfaqësuesve autentikë të komunitetit që synohet të përfaqësohet. PZAP vlerëson se përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në Kuvend, përmes vendeve të rezervuara, nuk mund të jetë as formal e as fiktiv, por duhet të mbështetet në ekzistimin e një lidhjeje objektive ndërmjet përfaqësuesit dhe komunitetit përkatës. Kjo lidhje objektive mund të shprehet përmes elementeve si përkatësia etnike, përdorimi i gjuhës, identiteti kulturor, apo angazhimi publik dhe shoqëror brenda komunitetit.

Në rastin konkret, subjekti politik VAKAT gëzon statusin e partisë politike të komunitetit boshnjak dhe garon për vendet e rezervuara të parashikuara për këtë komunitet. Për rrjedhojë, kandidatët e këtij subjekti duhet të kenë lidhje reale, të vërtetë dhe të provueshme me komunitetin boshnjak. Kandidatja Ena Krasniqi në ankesën e saj ka pretenduar se për nga gjaku i takon përkatësisë etnike boshnjake, e cila është rritur në kulturën boshnjake, gjuhën amtare gjuhën boshnjake, se është e lindur nga nëna e saj Mirsada Kamberovic dhe se duke qenë gjatë tërë kohës me familjarët e saj boshnjake në Kosovë të njëjtës askush nuk mund të ia mohojë përkatësinë etnike të saj. PZAP vlerëson se nga shkresat e lëndës rezulton se, me rastin e aplikimit për certifikim, si dhe më pas përmes ankesës para PZAP-it, kandidatja Ena Krasniqi nuk ka paraqitur asnjë provë që do të dëshmonte ekzistimin e lidhjes objektive me komunitetin boshnjak, në veçanti lidhjen e përkatësisë etnike, pa përjashtuar elemente të tjera si gjuha apo identiteti kulturor. Po ashtu, kandidatja nuk ka ofruar argumente që do të kundërshtonin pretendimin se në zgjedhjet lokale të vitit 2009 ka marrë pjesë si kandidate në listën e një subjekti politik të komunitetit shumicë.

Mbi këtë bazë, Paneli vlerëson se KQZ, me vendimin Nr. 01/3770/2025, të datës 10.12.2025, ka vepruar drejtë kur ka refuzuar rekomandimin e Zyrës për Certifikim lidhur me certifikimin e kandidates Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicioni Vakrat. Kjo për arsye se Koalicioni Vakrat garon për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025 për



vendet e garantuara, të cilat, në përputhje me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 111 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, janë vende ekskluzivisht të rezervuara dhe të garantuara për komunitetet joshumicë në Republikën Kosovës, e jo për komunitetin shqiptar. Për këtë arsye, dhe bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendet e garantuara, janë të obliguara që në listat e tyre të kandidatëve për deputetë të përfshijnë vetëm kandidatë nga komuniteti të cilit i përket subjekti politik përkatës, e jo nga komuniteti shqiptar. Në rastin konkret, Koalicioni Vakrat nuk ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore dhe me procedurat për aplikim të subjekteve politike që garojnë për vendet e garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP vlerëson se vendimi i KQZ-së për mos certifikimin e kandidates nuk përbën cenim të nenit 45 të Kushtetutës. E drejta për t'u zgjedhur, ndonëse e garantuar, nuk është e drejtë absolute dhe ushtrohet brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj. Në rastin konkret, kandidatja nuk po pengohet të marrë pjesë në zgjedhje në përgjithësi, por po kufizohet nga kandidimi në listën e një subjekti politik që përfaqëson një komunitet tjetër, për të cilin ajo nuk ka dëshmuar ekzistimin e lidhjes objektive të kërkuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Koalicioni Vakrat, lidhur me pretendimet për Certifikimin e Kandidates Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicioni Vakrat. Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe veçanërisht vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 17 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: "1. Zyra shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji, atëherë Zyra brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm. 2. Aplikuesi i cili pranon njoftimin sipas paragrafit 5 të nenit 13 të këtij ligji, ka afat pesë (5) ditë pune për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar apo një shpjegim që adreson brengat e identifikuar në njoftim. 3. Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje. 4. Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve. 5. Pas vendimit të KQZ-së, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit dhe në rast të



refuzimit, ofron arsyetimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin për të drejtën e tij për t'u ankuar në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve. PZAP vendos për ankesën brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i saj.”.

Me nenin 11 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të këtij ligji, parashihet se: “1. Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës. 2. Njëqind e njëzet (120) vendet në Kuvend zgjidhen me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura dhe ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon: 2.2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.”.

Me nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Me nenin 64 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: “1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. 2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon: (2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.



Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozitat e lartcekura, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik Koalicija Vakrat është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm.

Në raport me pretendimin e ankuesit se KQZ dhe PZAP, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së, sepse nuk është përfillur rekomandimi nga Departamenti për Certifikim të Partive Politike të KQZ-së, i cili rekomandim ishte profesional dhe i mbështetur në prova, këtë pretendim Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon si të pa bazuar. Në këtë rast duhet të kemi parasysh se propozimi nga Departamenti për Certifikim të Partive Politike të KQZ-së, nuk është i detyrueshëm që të zbatohet në mënyrë apriori, i njëjti propozim vlerësohet nga KQZ dhe varësisht prej përfundimit në përputhje me dispozitat ligjore mund të miratohet ose refuzohet aplikimin për certifikim, ashtu siç ka ndodhur në rastin konkret. Andaj nga provat dhe shkresat e lëndës shihet se vendimi i KQZ-së ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe kushtetutë.

Në raport me pretendimet ankimore të ankuesit se PZAP, gabimisht ka vlerësuar faktin se kandidatja Ena Krasniqi, nuk i plotëson kriteret për tu certifikuar në listën e subjektit politik Koalicija Vakrat, me numër rendor 6, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025, për faktin se kandidatja është e lindur nga e ëma boshnjake dhe ka lidhje të gjakut dhe se si gjuhë amtare e ka gjuhen boshnjake, këto pretendime Gjykata Supreme e Kosovës i refuzoi si të pabazuara.

Në rastin konkret Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimi se një kandidat për deputet mund të kandidojë për përfaqësim të një komuniteti për të cilin Kushtetuta dhe Ligji parashohin vende të garantuara, vetëm mbi bazën e origjinës etnike nga ana e nënës, nuk është në përputhje me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në parimin e shtetit multi-etnik dhe të barazisë ndërmjet komuniteteve, parashikon mekanizma të veçantë përfaqësimi për komunitetet joshumicë, përfshirë vendet e garantuara në Kuvend, me qëllim sigurimin e përfaqësimit të tyre real, efektiv dhe autentik. Ky rregullim kushtetues nuk synon thjesht përfaqësim formal, por mbrojtjen e identitetit politik, kulturor dhe shoqëror të komuniteteve, si dhe mundësinë që interesat e tyre të artikulohen nga persona që realisht i përkasin atij komuniteti.

Në frymën e Kushtetutës, përkatësia etnike për qëllime të përfaqësimit politik nuk kuptohet si një lidhje e thjeshtë biologjike, por si një marrëdhënie reale dhe e qëndrueshme ndërmjet individit dhe komunitetit përkatës. Kjo nënkupton vetë identifikim të sinqertë dhe të vazhdueshëm, identifikim shoqëror dhe lidhje reale me jetën, interesat dhe shqetësimet e atij komuniteti. Një interpretim që do ta reduktonte përkatësinë etnike vetëm në lidhje gjaku vetëm nga njëri prind, apo të afërm familjar tjerë do të ishte në kundërshtim me qëllimin e dispozitave kushtetuese për përfaqësimin e komuniteteve dhe do ta zbraste nga përmbajtja mekanizmin e vendeve të garantuara.

Ky qëndrim mbështetet edhe nga standardet ndërkombëtare, veçanërisht nga Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshillit të Evropës, e cila garanton të drejtën e individëve për vetë identifikim, por njëkohësisht kërkon që masat afirmative për pakicat të zbatohen në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim real dhe efektiv të tyre. Konventa nuk e koncepton përkatësinë



ndaj pakicës si një instrument oportunist që mund të aktivizohet rastësisht për përfitime politike, por si një element identitar që duhet të reflektojë lidhje reale dhe të qëndrueshme me komunitetin përkatës.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se lejimi i kandidimit për vende të garantuara vetëm mbi bazën e prejardhjes familjare do të binte ndesh si me frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu edhe me standardet e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshillit të Evropës, pasi do të rrezikonte keqpërdorimin e masave afirmative dhe do të cenonte përfaqësimin autentik të komuniteteve joshumicë. Një praktikë e tillë do të krijonte precedent të rrezikshëm, duke e shndërruar përkatësinë etnike në mjet të përkohshëm politik, në vend që ta trajtonte si kategori kushtetuese të mbrojtur dhe të lidhur me identitetin real të komuniteteve. Në rastin konkret kandidatja Ena Krasniqi në listën e subjektit politik Koalicija Vakrat, nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete që do të dëshmonte lidhjen e saj reale me atë komunitet apo kontributin e tij për të mirën e tij. Në mungesë të çdo dëshmie për angazhim të vazhdueshëm shoqëror, kulturor, politik apo institucional në mbrojtje dhe avancim të interesave të atij komuniteti, pretendimi për përfaqësim mbetet thjesht deklarativ dhe pa bazë faktike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme përfaqësimi kushtetues i komuniteteve joshumicë synon që interesat e tyre të artikulohen nga persona që jo vetëm identifikohen realisht me komunitetin, por edhe kanë dëshmuar përmes veprimeve konkrete përkushtim dhe kontribut për zhvillimin, mbrojtjen dhe fuqizimin e tij. Mungesa e provave për një kontribut të tillë tregon se kandidatja Ema Krasniqi nuk ka krijuar asnjë lidhje reale dhe të verifikueshme me komunitetin përkatës, çka e bënë të pabazuar dhe në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe standardeve për mbrojtjen e komuniteteve çdo pretendim për përfaqësim të tij.

Andaj si rezultat i kësaj kjo gjykatë erdhi në përfundim se, vetëm prejardhja biologjike sipas dhe vet deklarimit të kandidatës në fjalë se, është e lindur nga e ëma boshnjake dhe ka lidhje të gjakut dhe se si gjuhë amtare e ka gjuhen boshnjake, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është e mjaftueshme për të legjitimuar kandidimin e saj për përfaqësim të një komuniteti me vende të garantuara, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me qëllimin, frymën dhe funksionin mbrojtës sipas përcaktimit bërë me dispozitat Kushtetuese dhe ligjore, qëllimi i se cilave para se gjithash është që garantojnë dhe sigurojnë përfaqësimin real, efektiv dhe autentik për komunitetet joshumicë, për mbrojtjen e identitetit politik, kulturor dhe shoqëror të komuniteteve, si dhe mundësinë që interesat e tyre të artikulohen nga persona që realisht i përkasin atij komuniteti. Pra, më një fjalë qëllimi i normave kushtetuese dhe ligjore, nuk është thjesht vetëm çështje e përfaqësimit formal për komunitetet joshumicë, por çështje e cila atyre edhe ju garanton dhe siguron përfaqësimin real që interesat e tyre të artikulohen nga persona që realisht i përkasin atij komuniteti.

Në raport me pretendimet e ankuesit se vendimi i KQZ-së dhe vendimi i PZAP-së, është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, këtë pretendim Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon si të pabazuar. Në rastin konkret duhet të kemi parasysh se neni 45 garanton të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, por kjo e drejtë ushtrohet brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore dhe nuk ka karakter absolut. Vetë Kushtetuta parashikon rregullime të



veçanta për ushtrimin e kësaj të drejte, përfshirë mekanizmat specifikë të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë, të cilët synojnë sigurimin e barazisë reale dhe përfaqësimit efektiv të tyre.

Moslejimi i certifikimit në rastin konkret nuk e privon kandidatin nga e drejta për t'u zgjedhur në kuptimin e përgjithshëm të nenit 45, pasi atij nuk i ndalohej pjesëmarrja në zgjedhje si e tillë, por vetëm i pamundësohet kandidimi në kuadër të një mekanizmi të veçantë kushtetues që është i rezervuar për një kategori të caktuar subjektsh, përkatësisht për anëtarët e komunitetit përkatës. Një dallim i tillë nuk përbën diskriminim dhe as kufizim të pajustificuar të së drejtës zgjedhore, por është pasojë e drejtpërdrejtë e zbatimit të dispozitave kushtetuese që parashohin masa afirmative për komunitetet joshumicë.

Pa marrë parasysh se edhe Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshillit të Europës, por edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në parim nuk e ndalojnë që pjesë e një koalicioni apo partie të certifikuar për komunitetet joshumicë të jetë edhe kandidati i cili nuk përket etnisë të cilin e përfaqëson ai koalicion apo parti, vet fakti i mandatit të garantuar sipas qëllimit për të cilin shërben nga aspekti kushtetues, do duhej të shërbente si mekanizëm mbrojtje dhe fuqizimi të atij komuniteti joshumicë përkatës, në përfaqësimin real, substancial, efektiv dhe autentik të tyre.

Prandaj, vetëm fakti se një kandidat mund të deklarohej si pjesëtar i komunitetit joshumicë të caktuar siç kemi të bëjmë edhe në rastin konkret me kandidatin Ena Krasniqi, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ky fakt nuk paraqet garancë të mjaftueshme se ky komunitet joshumicë përmes këtij kandidati do të ketë përfaqësim substancial në mbrojtjen dhe avanciminin e interesave të atij komuniteti, por në të njëjtën kohë për situata të ngjashme në të ardhmen mund të shërbejë si adut për keqpërdorime sistematike për përfitime elektorale, të cilat do mund të kenë pasoja negative në drejtim të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë sipas vendeve të cilat i kanë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kësaj ankese, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas ankesës të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.132/2025 datë 16.12.2025.

Kryetar i kolegjit,
Qerim Ademaj



Republika e Kosovës
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / SUBSIDI SAVET KOSOVA / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-130/2025

FIETËDËRGESË PËR DORËSIM PERSONAL

PZABP - PRISHTINE DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lapinierimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës, së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdesitari të ndërtësës, i qitit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto prinitac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrnce susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto prinitac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (priobeno na vratima stana odnosno prostorije gde prinitac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dona _____ u _____ cns.
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshtkrimi i dorëzuesit - poppis dostavljaoca

Emri i shkresës që dorëzohet:
Nastov pisma koja se dostavlja:

AKTUEPILN

16.12.2025

Numri i shkojave: _____
broj priloga _____

2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjujeno prijem gorcnavegenog pisma
(i slovima)

Atesta. 19.12.2025
(Nënshtkrimi i marrësit ose i atit që
e ka marrë aktin në vend të tij
Poppis primaoca ili licu koje je
pismo prinito u zamezu)

Nënshtkrimi i dorëzuesit - poppis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshtkruajë dorëzuesit, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshtkrimin e vet. Ako je prinitac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljaoc, napomenom zasto prinitac nije stavio svoj potpis.